

Zoti bekofte kedo qe jep dashuri dhe solidarizohet ne keto dite te veshtira



Respekt dhe mirenjohje maksimale per kedo qe na u bashkua edhe sot ne nismen e Rinise Orthodhokse te Tiranës per te ndihmuar rreth 150 persona PA DALLIM FETAR, te cilet po strehohen aktualisht ne manastirin e Hirshem te Shen Vlashit Durrës, i cili ka hapur dyert per te strehuar qytetare te Durrësit, per shkak se banesat e tyre jane shkaterruar apo ndodhen ne rrezik dhe janë klasifikuar si te pabanueshme prej 3 ditesh.

Ushqime, veshmbathje, ilaçe si dhe vlerat monetare te dhuruara, kane shkuar ne Manastir dhe jane vene ne dispozicion te njerezve ne keto situata shume te veshtira.

Te dashur besimtare dhe kushdo tjetër qe e lexon kete njoftim:

Ju sigurojmë se nga dhuratat qe keni ofruar NUK do te humbase asgje!

Te gjitha jane strukturuar qe te perfundojne ashtu siç njoftohet kur behet thirrje per

ndihme.

Një ekip i tere klerikesh, punonjesish, studente te Teologjise dhe vullnetaresh, po punojne me perkushtim dhe vetemohim per t'iu qendruar sa me prane ketyre njerezve.